



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS**  
**KOSOVA CHAMBER OF ADVOCATES**  
**ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA**

*Prishtinë, rr. Qamil Hoxha 10/3*  
*Tel/fax 038/244-586*

**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS**

**KODI I ETIKËS PROFESIONALE TË AVOKATIT**

*Prishtinë, Kosovë*

*01.12.2012*

## **I. PARIMET THEMELORE**

### **Neni 1.**

Kodi i etikës profesionale të avokatit (në tekstin e mëtejme Kodi), përcakton parimet dhe rregullat e sjelljes, të cilave, për shkak të ruajtjes së nderit, dinjitetit dhe reputacionit të avokatisë, avokatët që veprojnë në Kosovë janë të obliguar t'iu përmbahen gjithnjë gjatë kryerjes së shërbimit të tyre.

### **Neni 2.**

Parimet themelore i përmban deklarata mbi betimin solemn, të cilin çdo avokat e jep para fillimit të veprimtarisë së avokaturës, me ç' rast është i obliguar që të njoftohet me përmbajtjen e Kodit të Etikës dhe Statutin e OAK-së. Këto parime duhet të jenë pjesë përbërëse e vetëdijes dhe bindjes së secilit avokat.

Mosnjohja e Statutit dhe Kodit të Etikës së OAK-së nuk e arsyeton avokatin për çfarëdo shkelje të dispozitave të tyre.

### **Neni 3.**

Avokati vazhdimisht duhet t' i thellojë njohuritë e tij; duhet ta përcjellë literaturën që ka të bëjë me profesionin e tij dhe çdo ngjarje aktuale, përparimin shkencor dhe kulturor, ngjarjet politike, etj. Sipas mundësive të veta dhe kompetencës profesionale, avokati duhet të marrë pjesë dhe t'ia ofrojë bashkëpunimin e tij, Odës së Avokatëve dhe shoqatave të tjera.

### **Neni 4.**

Avokati, në cilësinë e ekspertit, mund të angazhohet si këshilltar, bashkëpunëtor, anëtar i ndonjë organi ligjdhënës, trupave profesionale, grupeve të punës me karakter qeveritar dhe joqeveritar, në organizata humanitare, organizata për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, këshillave botuese, anëtarë apo këshilltar në ndonjë organizatë për ofrimin e njohurive profesionale, me kusht që kjo të mos jetë marrëdhënie e rregullt e punës që është në s'përputhje me profesionin e avokatit.

### **Neni 5.**

Qëndrimi i avokatit ndaj palës së vet, palës së kundërt dhe përfaqësuesve të saj, ndaj avokatëve të tjerë, gjykatave, avokatëve publikë, institucioneve shtetërore dhe autoriteteve tjera, të cilat avokati i ndihmon klientit ose e përfaqëson atë, duhet të përcaktohet, në mënyrë që të veprojnë dhe kërkojnë përfilljen e të drejtave dhe lirive themelore të tyre.

## **Neni 6.**

Në paraqitjet e tij, në parashtresat, ligjërimet, veprimet e tjera zyrtare dhe në përgjithësi në paraqitjet publike dhe private, avokati duhet të ketë kujdes në kërkesat profesionale dhe të dëshmojë kulturë juridike dhe të përgjithshme.

## **Neni 7.**

Gjatë kryerjes së profesionit të avokatit, me sjelljet e veta, duhet të përvetësojë dhe forcojë besimin e klientit, të organeve të judikaturës dhe të organeve të tjera para të cilave paraqitet. Është në natyrën e misionit të tij, që nuk mund të ketë marrëdhënie besimi, në qoftëse dyshohet në ndershmërinë, çiltërinë, drejtësinë dhe sinqeritetin e avokatit.

Avokati nuk duhet të favorizojë pikëpamjet politike apo anëtarësimin partiak gjatë ushtrimit të profesionit të tij.

## **Neni 8.**

Avokati është i obliguar, që me ndërgjegje t'i plotësojë detyrat, që dalin prej profesionit dhe të ruajë nderin, respektin dhe dinjitetin e avokatisë, gjatë kryerjes së profesionit të tij dhe në jetën private.

Avokati duhet t'i mbrojë interesat e klientit të vet vetëm me mjete, që janë në përputhje me ligjin dhe dinjitetin e profesionit të avokatit.

## **Neni 9.**

Avokati duhet vazhdimisht t'i thellojë njohuritë e tij. Ai duhet të ndjekë nga afër çdo ngjarje aktuale, përparimin shkencor dhe kulturor. Sipas mundësive të veta, ai duhet të marrë pjesë dhe të ofrojë bashkëpunimin e tij me Shoqatën e vet ose me shoqatat tjera.

## **Neni 10.**

Gjatë përfaqësimit, avokati është i obliguar ta ruajë pavarësinë e tij të plotë, të liruar nga çdo trysni, posaçërisht nga ato që dalin nga interesat e tij vetjake ose nga ndikimet e jashtme. Ai duhet t'i shmanget çfarëdo cenimi të pavarësisë së tij dhe të respektojë etikën e tij profesionale.

## **Neni 11.**

Avokati nuk duhet t'i pranojë punët që nuk janë në përputhje me thirrjen e tij dhe që do të dëmtonin pavarësinë, reputacionin dhe prestigjin e avokatisë.

Interesi dhe kërkesa e klientit nuk janë arsye të shkelje të Ligjit, Statutit dhe Kodit. Avokati mund të shërbehet vetëm me mjete të lejuara dhe të ndershme.

## **Neni 12.**

Avokati nuk duhet pa arsye ta refuzojë rastin juridik që i është caktuar sipas detyrës zyrtare, nga gjykata apo Oda.

## **Neni 13.**

Është në kundërshtim me nderin dhe prestigjin e avokatisë, çdo jo lojalitet në afarizëm, e veçanërisht:

- tërheqja e klientëve nëpërmjet ofertave, ndërmjetësuesve dhe reklamave,
- dhënia e autorizimeve blanko ose material reklamues,
- bashkëpunimi me laikë apo persona të dyshimtë që ushtrojnë punët e avokatisë;
- premtimi i provizionit ose shpërblimit personave tjerë, për t'i tërhequr klientët,
- mospërfillja dhe fyerja e avokatëve tjerë,
- thirrja në lidhje të ngushta shoqërore, etj.

## **Neni 14.**

Profesioni i avokatit njëkohësisht nuk ushtrohet me:

- profesionin e gjyqtarit efektiv, bashkëpunëtorit profesional dhe të nëpunësit në organet shtetërore;
- punën në industri dhe në tregti;
- asnjë marrëdhënie të rregullt të punës.

## **II. FSHEHTËSIA PROFESIONALE**

## **Neni 15.**

Avokati është i detyruar ta përfillë fshehtësinë e klientit të tij, i cili i jep njoftime të besueshme. Avokati duhet të vlerësojë vetë se çfarë dëshiron pala që të ruhet si fshehtësi. Avokati është i obliguar të kujdeset, që fshehtësinë ta ruajnë edhe personeli i tij dhe kushdo që bashkëpunon me të, në punën e tij.

## **Neni 16.**

Fshehtësi të avokatit, përbën çfarëdo informata të besueshme, me të cilat njihet në suaza të veprimtarisë së tij, të gjitha shkresat, shënimet tonike, llogaritare, të fotografuara dhe shënimet e ngjashme.

### **Neni 17.**

Për mbrojtjen e fshehtësisë profesionale, avokati nuk guxon të japë kurrfarë shënimesh, për lëndët të cilat i janë besuar si avokat, edhe pas pushimit të përfaqësimit të palës.

### **Neni 18.**

(a) Avokati nuk duhet të zbulojë informatën e mbrojtur sipas fshehtësisë profesionale, madje edhe pas përfundimit të përfaqësimit të palës, përveç nëse:

- i. Klienti pajtohet për nxjerrjen në shesh;
- ii. Nxjerrja në shesh është e lejuar sipas paragrafit (b).

(b) Avokati mund ta zbulojë informatën e mbrojtur sipas fshehtësisë profesionale, kur:

- i. Nxjerrja në shesh paraqet interes shtetëror ose është e domosdoshme, për shkak të rrezikimit të integritetit territorial të Kosovës;
- ii. Nxjerrja në shesh është arsye e domosdoshme për të penguar vdekjen eventuale ose lëndimi;
- iii. Të mbrohet kundër padisë së paraqitur nga klienti kundër avokatit;
- iv. Të sigurojë këshillë ligjore, e cila dëshmon se avokati nuk e ka shkelur Kodin Etik;
- v. Të mbrohet nga mundësia e përdorimit të tij, si mjet për kryerjen e krimit ose mashtrimit ose
- vi. Të mos i shkelë rregullat e gjykatës ose të ligjit tjetër.

### **Neni 19.**

Avokati duhet t'u përmbahet rregullave të njëjta, edhe kur bëhet fjalë për fshehtësitë e personit juridik apo të ndonjë organi tjetër.

## **III. RAPORTET ME KLIENTIN**

### **Neni 20.**

Avokati mund ta refuzojë dhënien e ndihmës juridike në këto raste:

- Nëse klienti nuk është i gatshëm për t'i përmbushur obligimet ndaj avokatit lidhur me ndihmën juridike të cilën e kërkon klienti ;
- Nëse avokati e konsideron se rezultati i kërkesës së klientit për ndihmë juridike do të ishte i pasuksesshëm.

## **Neni 21.**

Rekomandohet që kontrata me shkrim të lidhet sipas marrëveshjes me klientin, kurse, detyrimisht kur klienti e kërkon atë.

## **Neni 22.**

Avokati nuk duhet t'i shkaktojë palës shpenzime të panevojshme. Ai e këshillon dhe e mbron klientin e tij me ndërgjegje dhe me zell. Ai e njofton rregullisht klientin me zhvillimin e lëndës së tij.

## **Neni 23.**

Avokati që e njuh personalisht palën kundërshtare, mund ta refuzojë përfaqësimin e palës tjetër. Nëse vendos ta marrë përfaqësimin, duhet ta njoftojë palën që më parë.

## **Neni 24.**

Avokati, të cilit Oda i ka lejuar dhënien e ndihmës së specializuar juridike, mund të refuzojë dhënien e të gjitha formave të ndihmës juridike, që nuk i takojnë specializimit të tij.

## **Neni 25.**

Avokati duhet të refuzojë dhënien e ndihmës juridike:

- nëse ai ose avokati tjetër që ka punuar ose punon në të njëjtën zyrë, të njëjtin rast ose rastin që juridikisht është i lidhur me të, e kanë përfaqësuar më parë ose kanë dhënë këshilla dhe udhëzime juridike për të,
- nëse në të njëjtën çështje ose në çështjen me të cilën juridikisht është e lidhur, ka punuar si avokat praktikant te avokati që e ka përfaqësuar palën e kundërt,
- nëse në të njëjtën çështje ose çështjen që juridikisht është e lidhur me të ka punuar si gjyqtar, prokuror, avokat publik ose si person zyrtar në procedurën administrative apo ndonjë procedurë tjetër,
- në rastet e tjera të parashikuara me ligj, Statut dhe Kod.

## **Neni 26.**

Avokati nuk duhet ta tërheq autorizimin për përfaqësim, përveç nga arsyet e parashikuara me këtë Kod, sipas të cilave është i detyruar ose i autorizuar ta refuzojë ndihmën juridike.

## **Neni 27.**

Avokati që ka tërheq autorizimin me kërkesën me shkrim të gjykatës, është i

obliguar ta përfaqësojë palën edhe më tej, derisa pala nuk gjen një avokat tjetër, por më së shumti deri në 30 ditë prej ditës së revokimit të autorizimit, për veprimet që nuk durojnë shtyrje.

#### **Neni 28.**

Raportet avokat-klient, që i tejkalojnë marrëdhëniet zyrtare, janë të ndaluara, nëse raporti kërcënon pavarësinë profesionale të avokatit.

#### **Neni 29.**

Nëse avokati është anëtar ose punon në zyrën e përbashkët të avokatëve, nuk mund t'i japë ndihmë juridike palës së kundërt. Palë e kundërt është secila palë, që është në kontest me palën e secilit avokat, në zyrën e përbashkët të avokatëve.

#### **Neni 30.**

Nëse është në interes të palës të cilën e përfaqëson, avokati para fillimit të procedurës apo edhe gjatë procedurës duhet të insistojë që kontesti në mes tyre të zgjidhet me marrëveshje duke i bërë të njohura paraprakisht palës përparësitë e zgjidhjes së kontestit me marrëveshje.

### **IV. MBROJTJA DHE PËRFAQËSIMI NË ÇËSHTJET PENALE**

#### **Neni 31.**

Avokati është i obliguar të marrë mbrojtjen e ofruar të të pandehurit, pavarësisht nga personaliteti i të pandehurit dhe lloji i veprës, si dhe të përfaqësojë palën e dëmtuar në çështjet penale.

#### **Neni 32.**

Avokati nuk duhet ta refuzojë mbrojtjen në çështjet penale për shkak se mbrojtja është e vështirë, se ekzistojnë prova të pamohueshme mbi veprën e kryer, se pala ka pranuar kryerjen e veprës, për shkak të peshës së veprës dhe reagimet e opinionit publik.

#### **Neni 33.**

Avokati ka për detyrë që pas përfundimit të lëndës, me kërkesën e palës, t'ia kthejë të gjitha dokumentet origjinale që ia ka dorëzuar klienti.

## **V. RAPORTET ME ODËN**

### **Neni 34.**

Avokati ka për detyrë që t'i plotësojë detyrimet e tij ndaj Odës, ta respektojë, ta ruajë dhe ta ngritë autoritetin dhe prestigjin e saj.

### **Neni 35.**

Avokati ka për detyrë të marrë pjesë në aktivitetet e organeve të Odës, dhe të kontribuojë në punën e suksesshme të tyre.

### **Neni 36.**

Zgjedhja në çfarëdo organi të Odës, është nder për secilin avokat dhe zgjedhjen mund ta refuzojë vetëm për shkaqe të arsyeshme.

### **Neni 37.**

Avokati duhet të kujdeset që marrëdhëniet kolegjiale të zhvillohen me shumë sukses. Mosmarrëveshjet eventuale duhet të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve apo arbitrazhit të emëruar nga Oda.

### **Neni 38.**

Shkelje veçanërisht e rëndë e detyrës së avokatit, konsiderohet:

- moszbatimi i vendimeve të Odës dhe Këshillit Drejtues të saj,
- dhënia e shënimeve të pavërteta këtyre organeve,
- çdo sjellje fyese gjatë korrespondencës me shkrim ose me gojë me këto organe,
- moskryerja e obligimeve materiale ndaj Odës.

### **Neni 39.**

Këto detyrime avokatët i kanë edhe në raport me Tubimet regjionale.

## **VI. RAPORTET ME GJYKATAT, ORGANET ADMINISTRATIVE DHE ME AUTORITETET E TJERA SHTETËRORE**

### **Neni 40.**

Avokati, në kryerjen e profesionit të vet, ka për detyrë që gjithnjë të ruajë autoritetin e gjykatave, organeve të administratës dhe autoriteteve tjera pranë të cilave jep ndihmë juridike dhe të shprehë respektin e duhur ndaj tyre.



**Neni 41.**

Avokati, para gjykatës, nuk duhet të japë deklarata fyese ose mendime nënçmuese mbi vendimet e tyre.

**Neni 42.**

Me paraqitjet e tij pranë gjykatave, avokati duhet të arsyetojë dhe të vërtetojë bindjen, se është bashkëpunëtor në zbatimin e ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve dhe të interesave të tyre.

**Neni 43.**

Paraqitja e avokatit para gjykatave, organeve të administratës dhe autoriteteve tjera si me shkresa ashtu edhe me gojë, duhet të jetë sa më reale, e përmbledhur dhe në masën që nuk shkon në dëm të mbrojtjes së interesit të klientit.

**Neni 44.**

Gjatë dhënies së mbrojtjes apo përfaqësimit të palës, marrëdhëniet miqësore të avokatit me gjykatësin nuk mund të përdoren në favor të klientit.

**Neni 45.**

Avokati është i obliguar të kundërshtojë, nëse gjykatësi ndaj avokatit, praktikantit ose klientit të tij, sillet si ndaj personave të nënshtruar. Avokati me sjelljen dhe qëndrimet e veta duhet ta bind gjykatësin se në esencë është bashkëpunëtor në marrjen e vendimeve të drejta.

**Neni 46.**

Avokati duhet ta këshillojë palën e vet, që t'u shprehë respektin e duhur gjyqtarëve.

**Neni 47.**

Avokati ka për detyrë të kujdeset, që palës t'i ofrojë mbrojtje të nevojshme juridike sa më shpejtë që është e mundur si dhe të pamundësojë çdo zvarritje dhe keqpërdorim të drejtave para gjykatave dhe organeve tjera.

**Neni 48.**

Avokati duhet ta mbrojë klientin në përputhje me rregullat juridike. Assesi nuk duhet t'i japë gjyqtarit me vetëdije ndonjë informatë të rrejshme ose të natyrës së tillë që ta shtyjë të gabojë.

## **VII. DETYRIMI I INFORMIMIT MBI SHPERBLIMET**

### **Neni 49.**

Avokati duhet ta njoftojë palën me kërkesën e tij për të gjitha ato që i kërkon si shpërblime për punën e bërë dhe për të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me atë lëndë. Ai, duhet gjithashtu, ta njoftojë klientin mbi shpenzimet, për të cilat ka vendosur gjyqtari dhe që bien mbi palën tjetër.

### **Neni 50.**

Avokati, ka të drejtë që në fillim të kërkojë shpërblimin nga pala.

### **Neni 51.**

Po që se klienti i interesuar kundërshton ta paguajë avokatin, ai mund ta pezullojë punën në rastin e tij, pasi e ka paralajmëruar palën. Avokati ka të drejtë të paguhet për punën që ka bërë deri atëherë sipas Tarifës së Avokatit apo marrëveshjes. Avokati, para se ta fillojë procedurën, duhet t' i bëjë vërejtje palës së kundërt, duke i dhënë një afat të pranueshëm për plotësimin e kërkesës kontestuese.

## **VIII. RAPORTET E AVOKATIT ME PALËN KUNDËRSHTARE**

### **Neni 52.**

Avokati duhet të sillet me respekt dhe dinjitet edhe ndaj kundërshtarit, duke u përpjekur që të krijojë kushte, që kontesti të zgjidhet sa më shpejt.

### **Neni 53.**

Avokati nuk duhet ta shfrytëzojë mosdijen, lajthimin ose frikën e palës kundërshtare, veçanërisht nëse ajo nuk ka përfaqësues juridik, për të arritur sukses të pajustificueshëm për palën e vet.

### **Neni 54.**

Avokati nuk mund të bashkëpunojë me palën kundërshtare, pa i njoftuar përfaqësuesit e saj dhe palën e vet.

### **Neni 55.**

Avokati të cilit i ofrohet pala për përfaqësim në çështjen civile, kundër palës më të

cilën avokati ka raporte të ngushta personale, është i detyruar që për këtë rrethanë ta njoftojë palën e cila kërkon ndihme.

#### **Neni 56.**

Avokati duhet të përpiqet ta bindë klientin, që të mos ndërmarrë ndjekje penale për palën kundërshtare, për shkak të deklaratave të pamatura që kanë shkaktuar gjendje të tendosur në procedurë, nëse një ndjekje e tillë nuk është e nevojshme për t'u siguruar interesi i palës. Avokati duhet t'i shmanget ndjekjes së palës së kundërt, nëse ajo në gjendje të shqetësuar ka dhënë deklaratë të pakëndshme dhe të papëlqyera.

#### **Neni 57.**

Në të gjitha rrethanat, avokati duhet ta ketë parasysh karakterin kontradiktor të debateve. Ai, fjala vjen, nuk mund të kontaktojë me një gjyqtar lidhur me një lëndë, pa e njoftuar për këtë punë palën kundërshtare ose avokatin e saj. Ai nuk mund t'i dorëzojë dokumente, shënime ose dëshmi të tjera një gjyqtari para se ato t'i komunikohen në kohën e duhur palës kundërshtare ose avokatit të saj, përpos në rastin kur veprimet e këtilla lejohen sipas rregullave të procedurës që zbatohet.

### **IX. RAPORTET RECIPROKE TË AVOKATËVE**

#### **Neni 58.**

Respekti që avokati i referohet profesionit të avokatit, e detyron atë të ketë raporte kolegjiale dhe lojale ndaj avokatëve, si dhe të ketë solidaritet profesional. Këto raporte nuk duhet të ndikojnë negativisht në ndërgjegjshmërinë dhe këmbënguljen e avokatëve, në përfaqësimin e palës vetanake.

#### **Neni 59.**

Avokati duhet të përmbahet nga çdo përpjekje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, në synimin që ta tërheqë për vete klientelën e një avokati tjetër.

#### **Neni 60.**

Avokatit, të cilit i drejtohet një avokat nga shteti i jashtëm për ndihmë juridike, duhet gjithnjë të jetë i vetëdijshëm, që ai avokat, në masë të madhe varet nga ndihma e tij dhe në këtë rast, përgjegjësia e avokatit është e madhe. Këto raste duhet të merren vetëm nëse mund të përpunohen profesionalisht dhe pa zvarritje.

### **Neni 61.**

Nëse avokatit i drejtohet pala që e përfaqëson një avokat tjetër, ai është i detyruar ta informojë kolegun.

### **Neni 62.**

Avokati është i detyruar, që ndaj avokatit të palës tjetër, të sillet me respekt të veçantë dhe t'i shmanget nënçmimit në çfarëdo mënyre, ta sulmojë ose ta shtyjë në konteste të panevojshme.

### **Neni 63.**

Kur një avokat kërkon që në një lëndë ta zëvendësojë ndonjëri prej kolegëve, ai duhet t'ia dorëzojë menjëherë dosjen, me të gjitha elementet e nevojshme, për ta vazhduar punën.

### **Neni 64.**

Kur shpenzimet dhe shpërblimet e avokatit të mëparshëm, nuk kontestohen ose nuk janë më objekt kontesti, avokati që e zëvendëson, mund ta marrë përsipër atë lëndë ose të marrë provizionin pa pëlqimin e kolegut të mëparshëm.

### **Neni 65.**

Avokati, që është caktuar të marrë përsipër lëndën e një nevojтари, mund dhe duhet t'i kryejë të gjitha detyrat, madje edhe ato që nuk janë urgjente.

### **Neni 66.**

Avokati duhet ta zëvendësojë një avokat tjetër që kërkon nga ai zëvendësimin, përveç në rastet kur është i penguar nga punët në lëndët tjera. Në rast se nuk ka mundësi ta bëjë këtë punë, avokati duhet ta njoftojë avokatin që ka kërkuar zëvendësimin.

### **Neni 67.**

Nëse dy avokatë të dy shteteve punojnë bashkë, që të dy kanë për detyrë të kenë parasysh ndryshimet e mundshme midis sistemeve të tyre ligjore, Odave të tyre të avokatëve, kompetencave dhe detyrimeve të tyre profesionale.

Në rast kontestimi të shpenzimeve dhe honorarëve ndërmjet avokatit dhe klientit, avokati që e zëvendëson, nuk mund ta marrë përsipër atë lëndë ose të marrë provizion, para se të shtrohet çështja te jurisdikcioni kompetent, lidhur me shpenzimet e avokatit të mëparshëm. Ky ndalim vlen deri në zgjidhjen e kontestit,

ose deri sa të bëhet pagesa ose të dorëzohet shuma e kërkuar. Avokati që vjen pas, përmbahet nga çfarëdo ndërhyrje në kontest.

#### **Neni 68.**

Avokati që vjen pas, megjithatë, mund t'i kryejë të gjitha detyrat urgjente, të cilat i kërkon mbrojtja e interesave të klientit, me kusht që për këtë punë, ta njoftojë menjëherë avokatin e mëparshëm. Ai nuk mund të marrë shpërblim për këtë ndërhyrje.

#### **Neni 69.**

Për shkak të bashkëpunimit kolegjal, avokati duhet ta informojë dhe ta këshillojë një avokat, kur ky i fundit këtë e kërkon, përveç në rast se ky është avokat i palës kundërshtare.

#### **Neni 70.**

Avokati duhet ta zëvendësojë një avokat tjetër që kërkon nga ai zëvendësimin, përveç në rastet kur është i penguar nga punët në lëndët tjera. Në rast se nuk ka mundësi ta bëjë këtë punë, avokati duhet ta njoftojë avokatin që ka kërkuar zëvendësimin.

#### **Neni 71.**

Korrespondenca në mes avokatëve është me mirëbesim. Për t'u trajtuar si e tillë, duhet të shprehet qartë vullneti nga dërguesi i kumtesës.

Ajo humb cilësinë e mirëbesimit dhe mund të jepet :

- 1) kur është fjala për një akt procedure,
- 2) kur ai cilësohet shprehimisht jo i mirëbesueshëm dhe kur cilësia e jomirëbesimit pranohet nga tjetri,
- 3) kur përmban ekskluzivisht një parashtrësë faktesh precize ose përgjigjen e kësaj parashtrëse.

## **X. RAPORTET ME PRAKTIKANTËT E AVOKATURËS**

#### **Neni 72.**

Avokatët, për të krijuar kuadro të afta në profesionin e avokatëve, duhet të pranojnë që në zyrat e tyre të ushtrojnë juristë të diplomuar të rinj, të aftë dhe të zellshëm.

Ai duhet ta përgatisë avokatin praktikant të zyrës së tij, për ta ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur, t'ia përcjellë njohuritë e veta profesionale dhe t'i ofrojë mundësinë për përvetësimin e praktikës dhe të njohurive të avokatisë.

### **Neni 73.**

Avokati duhet t'ia mësojë avokatit praktikant të zyrës së tij, parimet dhe rregullat e sjelljes, në mënyrë që ai ta përfillë dinjitetin njerëzor, ndershmërinë dhe të ketë sjellje të mirë, të denjë për profesionin e avokatit.

### **Neni 74.**

Avokati duhet të jetë shembull për avokatin praktikant dhe duhet ta vështrojë atë si bashkëpunëtor të njëmendët, në mënyrë që, në mes tyre, të ketë mirëbesim dhe përfillje të ndërsjellë.

### **Neni 75.**

Avokati duhet ta bëjë raportin e vet mbi sjelljen dhe punën e avokatit praktikant, që punon në zyrën e tij. Ushtrimi i praktikës duhet të bëhet me orar të plotë, e jo kohë pas kohe. Avokati nuk duhet ta bëjë raportin mbi një stazh fiktiv të avokatit praktikant, që nuk ka punuar kurrë në zyrën e tij.

### **Neni 76.**

Avokati duhet t'ia krijojë avokatit praktikant kushtet e duhura për punën e tij efikase.

Ai duhet ta shpërblejë ashtu si janë marrë vesh në fillim dhe duhet të veprojë në mënyrë që, avokati praktikant, të ketë kohë dhe kushte për përgatitjen e provimit të avokaturës.

### **Neni 77.**

Avokati duhet ta përcjellë me kujdes punën e praktikantit, të cilit nuk i lejohet kryerja e pavarur e punëve juridike.

### **Neni 78.**

Nëse lind kontest në mes avokatit dhe praktikantit, ata duhet të përpiqen, që kontestin ta zgjidhin me marrëveshje ose me ndërmjetësimin e organeve të Odës.

## **XI. NDIHMA JURIDIKE NEVOJTARËVE**

### **Neni 79.**

Dhënia e ndihmës juridike përfituesve të sistemit të ndihmës juridike falas, që i plotësojnë kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi është detyrë nderi e

avokatëve, të cilën duhet ta bëjnë njësoj me kujdes dhe ndërgjegje, si kur punojnë me palët e tjera.

**Neni 80.**

Secili avokat e ka për detyrë që të jetë vigjilent dhe të sigurojë funksionimin e mirë të radhës së punës së avokatëve në sistemin e ndihmës juridike.

**Neni 81.**

Avokati, i cili si përfaqësues e kërkon shpërblimin nga përfituesit e ndihmës juridike, ose nga personi i tretë, lidhur me përfaqësimin para përfundimit të përfaqësimit, bën shkelje të rëndë të detyrës dhe të prestigjit të avokatit.

**Neni 82.**

Po që se klienti kërkon ndihmën juridike falas, avokati duhet ta njoftojë për këtë mundësi.

Nëse nuk parashihet ndihma juridike falas dhe klienti nuk ka mundësi ta paguajë avokatin, ndihma juridike mund t'i jepet falas, ngase për klientët që gëzojnë ndihmë sociale, dhënia e ndihmës falas është pjesë e detyrimit tradicional dhe e ndershmërisë së avokatit.

Avokati duhet të ofroje ndihmë juridike falas (pro bono) nëse për këtë obligohet nga OAK.

## **XII. ORGANIZIMI NË ZYRËN E AVOKATIT**

**Neni 83.**

Avokati është i obliguar që zyra e tij dhe mënyra e punës në të t'i përgjigjet dinjitetit të profesionit të avokatit.

**Neni 84.**

Avokati ka për detyrë, që me kohë dhe me rregull t'i udhëheq lëndët, t'i arkivojë shkresat ,të mbajë evidencën e rregullt të afateve dhe gjykimeve, ashtu që ai dhe pala të kenë mundësi t'i vërtetojnë të dhënat mbi gjendjen e lëndëve, respektivisht që avokati organeve të Odës, konform Statutit, pa zvarritje t'i ofrojë të dhëna për punën e tij.

**Neni 85.**

Avokati është përgjegjës për punën e zyrës. Në zyrat e përbashkëta, të gjithë avokatët për punën e zyrës mbajnë përgjegjësi.

**Neni 86.**

Avokati posaçërisht duhet të jetë i saktë dhe i ndërgjegjshëm në punët me para. Paratë e klientit nuk duhet t'i ngatërrojë me paratë e veta dhe gjithëherë duhet te jete i gatshëm t'i paguajë ato. Paratë që i ka marrë për klientin, avokati duhet pa shtyrje t'ia dorëzojë klientit.

**Neni 87.**

Nuk lejohet që t'i ndalë apo përdorë parat të cilat avokatit i janë dhënë me destinim të caktuar.

Të zgjerojë të drejtën e retencionit dhe për shkak të kërkesave të përsëritura për shërbime që duhet t'i paguajë më vonë.

**Neni 88.**

Avokati duhet t'i plotësojë të gjitha detyrimet ndaj të punësuarve, në harmoni me ligjin dhe me kontratat mbi punën.

**Neni 89.**

Avokati duhet të vendosë firmën në ndërtesën në të cilën gjendet zyra, e cila as nga forma as nga përmbajtja, nuk duhet të shërbejë për qëllime reklamimi dhe komerciale.

**Neni 90.**

Avokati duhet të kujdeset që kontaktet dhe konsultimet me palën t'i mbajë në zyrën e vet. Përrjashtimisht avokati mund të kontaktojë dhe konsultojë palën edhe në vende tjera të përshtatshme por pa e dëmtuar prestigjin dhe autoritetin e avokatit.

**Neni 91.**

Avokati mund të paraqitet publikisht, në televizion, në radio ose në shtyp, mbi çështje me interes shkencor ose të përgjithshëm, ose përjashtimisht mbi çështje të caktuara. Me rastin e këtyre paraqitjeve, avokati, sipas rregullit, mund ta përdorë titullin e tij të avokatit.

**Neni 92.**

Avokati duhet t'i shmangët njoftimit të opinion publik mbi çfarëdo veprimtarie, që ka të bëjë me punën e tij ose me jetën e tij private, të cilat mund ta cenojnë reputacionin e tij si avokat ose reputacionin e avokatisë në përgjithësi.



### **XIII. Reklamimi dhe Kërkimi i Klientëve:**

#### **A. Firma dhe Reklamimi**

##### **Neni 93.**

(a) Avokati lejohet të lajmërojë në mjetet e informimit hapjen ose ndërrimin e zyrës, si dhe të shpallë njoftimin mbi hapjen e zyrës ose të ndërrimit të saj, nëpërmjet shkresës, e cila mund t'u dërgohet vetëm avokatëve, organeve të judikaturës dhe klientëve.

(b) Firma dhe reklamimi mund të përmbajnë:

- (1) Emrin e avokatit;
- (2) Informata kontaktuese;
- (3) Arsimimin paraprak;
- (4) Anëtarësinë në ndonjë organizatë profesionale dhe
- (5) Çfarëdo informate tjetër të lejuar nga Oda.

(c) Avokatit i lejohet që informatat nga pika (b) t'i paraqesë në faqen e internetit.

(d) Avokati nuk lejohet:

ta bëjë vënien e shenjës në formë dhe përmbajtje të stërmadhuar ose vënien e një pllake të tillë në vende të tjera jashtë ndërtesës së zyrës së avokatit,

- (1) të vendosë në formë të stërmadhuar titullin e specializimit dhe përdorimin e zmadhuar të vulës katrore ose asaj të rrumbullakët,
- (2) paraqitjet publike, lajmërimet në shtyp, internet dhe të ngjashme me theksime të tepruara të tipareve të avokatit, që mund të kuptohen si imponim opinionit.
- (3) në hyrjen e zyrës së tij të afishojë për prezantimin e tij të dhëna me qëllime publiciteti ose ta shënojë profesionin e tij të mëparshëm, me qëllim që të udhëheqë klientelën dhe as të reklamojë zyrën për punët që nuk i përkasin profesionit të avokatit (fotokopjim, përkthime, ndërmjetësime, etj).

##### **Neni 94.**

Avokati paraqitet në opinion me masë. Ai me kujdes duhet ta përfillë fshehtësinë profesionale dhe detyrimin që të jetë i përmbajtur dhe diskret. Ai duhet t'i shmanget ndërhyrjes së tij të shtrembëruar, duke kërkuar publicitet profesional.

##### **Neni 95.**

Avokati flet vetëm në emër të vet dhe me përgjegjësinë vetanake. Oda e Avokatëve nuk merr kurrfarë përgjegjësie për paraqitjet e tij.

## **B. Kërkimi i Klientëve**

### **Neni 96.**

Kërkimi i Klientëve ndalohet.

## **XIV SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT**

### **Neni 97.**

Avokati ka të drejtë në shpërblim, sipas Tarifës mbi shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatit.

Avokati me klientin e tij mundet që të kontraktojë shpërblimin e tij për punën e tij sipas marrëveshjes së lirë.

### **Neni 98.**

Avokati ka të drejtë, që para se të fillojë përfaqësimin, t'i kërkojë klientit t'ia paguajë shpenzimet e nevojshme. Nëse pala nuk ia jep avansin për mbulimin e shpenzimeve, avokati mund ta refuzojë përfaqësimin ose vazhdimin e përfaqësimit.

### **Neni 99.**

Avokati mund të kontraktojë shpërblimin e tij me klientin, para përfundimit definitiv të çështjes sipas të cilës klienti merr përsipër t'ia paguajë avokatit një pjesë të suksesit të çështjes, në harmoni me tarifën e OAK respektivisht sipas marrëveshjes me shkrim.

### **Neni 100.**

Avokatit, të cilit nuk i është paguar shpërblimi, nuk ka të drejtë që palës t'ia ndalë kthimin e shkresave origjinale, pas përfaqësimit të kryer. Është i obliguar që palës në kërkesën e tij t'ia kopjojë me shpenzime të tij, përshkrimin e të gjitha shkresave që i ka shkruar për të.

### **Neni 101.**

Avokati ka për detyrë, që palës t'ia mundësojë shikimin e Tarifës dhe me kërkesën e saj, t'ia japë llogarinë e specifikuar të shpenzimeve përveç kur për shpërblimin për punën e tij e ka përcaktuar me kontratë.

Në rastin e marrëveshjes me shkrim-kontratës avokati duhet ti përmbahet kontratës por nuk është i obliguar që të mbaj dhe të bëjë llogaritjen dhe specifikimin e shpenzimeve për punën e tij

## **Neni 102.**

Avokati nuk duhet ta kontraktojë, si shpërblim, objektin ose pjesën e objektit, nga kontesti që i është besuar për përfaqësim. Shpërblimi mund të bazohet vetëm në vlerën e objektit nga kontesti.

## **XV. HYRJA NË FUQI**

## **Neni 103.**

Kodi hynë në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës, me datë 01.12.2012

**Kryetari i Odës  
Ibrahim Dobruna**



The stamp is circular and contains the text: "ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS", "CHAMBER OF ATTORNEYS OF KOSOVO", "PRISTINA", "PRISTINA", "PRISTINA", and "AVOKATSKA KOMORA KOSOVO". A blue ink signature is written over the stamp.